

Koncept i shkurtër

për

Qendër rehabilitimi dhe zhvillimi me fushë mjekësore-terapeutike dhe trajnimi e kualifikimi në Pogradec/Shqipëri

Ky koncept është një përmbledhje e shkurtër e konceptit të plotë të detajuar prej 17 faqesh. Ai shërben si një letër prezantimi. Nqs jeni të interesuar mund të merrni versionin e plotë të konceptit nëpërmjet zyrës qendrore në Gjermani.

Hyrje

Ne si MNA „*Medizinische Nothilfe Albanien e.V.*“ (Ndihmë Mjekësore për Shqipërinë) ofrojmë në Shqipëri ndihmë zhvillimi në fushën mjekësore-terapeutike që prej vitit 1994, për përkujdesje mjekësore në raste emergjencash, mbështetje dhe ndihmë për njerëzit pas aksidentesh, sëmundjesh, aftësi të kufizuar dhe me nevojë për zhvillim/ndihmë.

MNA është një shoqatë gjermane, që ka filluar para 20 vitesh me vizita të shkurtra mjekësore në juglindje të Shqipërisë.

Për të bërë më të drejtë konceptin tonë „Ndihmë për vet-ndihmë“ në vitin 2009 ne themeluan shoqatën shqiptare „Qendra Drita e Shpresës“. Shoqata është regjistruar si një organizatë jo fitimprurëse (OJF).

Si atëherë, edhe sot motivimi ynë themelor është të japim një kontribut për të mbyllur boshllëqet mjekësore-terapeutike dhe sociale në Shqipëri.

Duke u mbështetur në vlerat e krishtera për pikëpamjen mbi njeriun, ne duam që të ndihmojmë nevojtarët, të moshuarit, të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara. Ne sillemi me ta me respekt, pranim, dinjitet dhe dashuri – pavarësisht se çfare feje, grupi etnik, shtrese shoqërore apo prejardhje politike i takon.

Me kalimin e kohës gjatë këtyre 20 viteve mbështetja jonë ka ndryshuar dhe është shndërruar nga një ndihmë e shpejtë në drejtimin e një „Ndihme për vet-ndihmë“ të qëndrueshme/afatgjatë.

Me qëllimin për të ofruar projektet e deritanishme, si ortopedi, fizioterapi, terapi për persona me nevojë kujdestarie, trajnim mjekësor dhe terapeutik, kualifikim si dhe terapi individuale në familje në një cilësi të mirë si nga ana organizatore ashtu edhe strukturore, ne duam t'i vendosim të gjitha në një ndërtesë, në të mëposhtmen të quajtur „Qendër Rehabilitimi“.

Qendra e rehabilitimit dhe zhvillimit

Sot në fazën progresive të ndërtimit të Shqipërisë, është koha që të ndërtohet një Qendër rehabilitimi dhe zhvillimi që të shërbejë si model trajnimi, shembulli dhe imitimi. Shqipëria ka treguar në vitet e kaluara që interesohet dhe mundohet të arrijë standartet e Bashkimit Europian. Qendra jonë e rehabilitimit duhet të shërbejë si „Projekt shembull“, që shërben si një mbështetës i fuqishëm dhe iniciator. Ai i shërben qëllimeve shqiptare për të arritur standartet e BE-së dhe njëkohësisht i shërben personave të prekur.

Ne ofrojmë metoda pune që shërbejnë si shembull dhe vendosim standarte në mënyrën e trajtimit individual të të sëmurëve, personave me aftësi të kufizuara dhe të aksidentuarve.

Ne ofrojmë vende trajnimi dhe kualifikimi themelore, në mënyrë që në Shqipëri të mund të zhvillohet një ndryshim mbarë kombëtar në sistemin shëndetësor.

Dëshira dhe qëllimi ynë është t'i mbështesim njerëzit pas aksidenteve, personat me aftësi të kufizuara, apo të sëmurët, për të hedhur hapa të kujdesshëm por të dukshëm në situatat përkatëse të jetës së tyre, në atë mënyrë që jeta e tyre të mund të ndryshojë. Atyre duhet t'iu jepet mundësia që sipas aftësive të tyre individuale, të jetojnë një jetë me vetbesim dhe të respektuar nga shoqëria.

Një kusht thelbësor për ne në procesin e ndryshimit është gjithmonë pranimi kulturor, ekonomik, politik si dhe financiar dhe mundësitë përkatëse në Shqipëri.

Në qendrën tonë të rehabilitimit në përputhje me qëllimet tona, ne ofrojmë projektet/fushat e mëposhtme:

- punishte ortopedike
- klinikë fizioterapi dhe masazhi
- projekt terapie dhe zhvillimi për personat me aftësi të kufizuara
- vende pune të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara
- trajnim, kualifikim dhe mësim në fushat mjekësore, terapeutike, përkujdesje, arsim për mësues të personave me aftësi të kufizuara
- biseda dhe këshillim i të afërmeve
- marrëdhënie me publikun, referate, simpoziume profesionale

Në këtë drejtim ne do të investojmë në qendrën tonë të rehabilitimit. Ne duam që dëshirën për mirëkuptim dhe ndryshim në sistemin shëndetësor shqiptar, t'ia ushqejmë në mënyrë të qëndrueshme politikës dhe shoqërisë për këtë grup njerëzish. Në të ardhmen e largët duhet të zhvillohet, të ndërtohet dhe përpunohet nga vet shqiptarët një rrjet mbarë kombëtar mundësish dhe masash për persona me sëmundje, aftësi të kufizuara dhe persona me nevojë të lartë përkujdesi/zhvillimi, si dhe të aksidentuarish. Gjithashtu ne mundohemi të vemë theksin në forcimin e një kulture bashkëpunimi ndërdisiplinar në Shqipëri. Vetëm atëherë kur disiplinat e ndryshme profesionale të mund të futen në mënyrë të barabartë në bisedë, mund të përpunohet një „plan ndihmues“ efektiv në interes dhe në të mirë të ndihmë-kërkuesve.

Një kontribut thelbësor për rrjetin mbarë kombëtar të mundësive/ofertave të ndryshme mjekësore-terapeutike është një ofertë trajnimi dhe shkollimi në gjuhën shqipe. Thelbësore këtu është marrja në konsideratë e mundësive kulturore, financiare në Shqipëri, si dhe miratimi nga shteti shqiptar i trajnimit dhe kualifikimit.

Për të ardhmen, ne kemi vendosur të investojmë shumë forcë dhe angazhim në këtë fushë. Hap pas hapi ne duam që në Qendrën tonë të rehabilitimit të zhvillojmë një paletë të shumëllojshme trajnimi dhe kualifikimi në fushat e lartpërmendura. Për të arritur plotësisht qëllimin tonë, ne duam dhe do të lidhim masat tona të trajnimit dhe kualifikimit në teori dhe praktikë.

Kostot

Kostot për ndërtimin/pajisjet	gjithsej	<u>177.900 €</u>
Kostot fikse/operative	në vit	<u>73.700 €</u>
Kostot e personelit	Kostot e pagave/vit	<u>61.000 €</u>

Blerja e objektit (opsionale) Ndërtesa me çmim blerje të ndryshme (sipas madhësisë) nga 650.000 € deri 847.100 €.

Fillimi i projektit: 1. Maj 2014

Konkluzion

Shqipëria është një vend në zhvillim në zemër të Europës jugore dhe përpiqet të arrijë standartet e Bashkimit European duke bërë hapa të guximshëm në këtë drejtim.

Ne jemi të bindur, që është detyra e donatorëve të pasur vendas për të instaluar "Projekte të tilla shembull" në vendet në zhvillim.

Çdo projekt që kontribuon nga ana sociale, ekonomike, infrastrukturore dhe stabilitetit familjar në vendin përkatës, është një faktor i rëndësishëm për të forcuar paqen e brendshme dhe të jashtme si dhe kënaqësinë e gjithë popullsisë.

Projektet tona në Shqipëri i shërbejnë edhe interesit të përbashkët europian.

Nëpërmjet mundësive që ne ofrojmë në trajnim dhe kualifikim (sistem dual arsimimi) në qendrën tonë të rehabilitimit, ne investojmë në të ardhmen shqiptarre. Ky investim është një bazë e rëndësishme për të përmirësuar infrastrukturën në një periudhë afatgjatë dhe për të ndaluar emigrimin e specialistëve në „botën e pasur“.

Oferta jonë për t'iu ofruar mundësi viktimave të aksidenteve dhe personave me aftësi të kufizuara vendos standarte.

Nëpërmjet mjeteve ndihmëse të përshtatshme dhe standarteve të strukturuar mjekësore dhe terapeutike, nëpërmjet krijimit të vendeve të punës për persona me aftësi të kufizuara, vendosen kushtet për një bashkëjetesë në shoqërinë shqiptare.

Ne jemi të bindur, që ia vlen të përshkruajmë këtë rrugë me forcën dhe angazhimin tuaj dhe tonin.

Ju lutemi për mbështetjen tuaj!

Balingen, 15.3.2014



Matthias Roller
(Kryetar i shoqatës MNA)

